



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:194645

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05856768

KE.nr. 60/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen juridike të paditësit “Princesha Group” Sh.P.K., me nr. të biznesit 70758520 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Ndue Përlleshi” Bregu i Diellit, nr. 10, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat Labinot Vata nga Prishtina, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Ekonomisë dhe Financave-Administrata Tatimore e Kosovës, që sipas autorizimit përfaqësohet nga Artan Krasniqi, me objekt kontesti kompensim i dëmit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 06.06.2024 në të cilin prezantuan të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me datën 25.06.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Princesha Group” Sh.P.K., me të cilin ka kërkuar që të detyrohet e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Ekonomisë dhe Financave-Administrata Tatimore e Kosovës, që në emër dëmit material dhe jo material për shkak të bllokimit të kundërligjshëm të llogarive bankare nga e paditura, t’ia kompensoj paditësit shumën prej 2,503.400.20 EUR, me kamatë ligjore në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.
- II. Secila palë ndërgjyqëse i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

1. Çështja gjyqësore dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi “Princesha Group” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, me datë 09.10.2014 ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Ekonomisë dhe Financave-

Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, me objekt kontesti kompensim i dëmit real dhe fitimit të humbur.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda në fjalë, sipas kompetencës lëndore është transferuar pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike.

Në referatin e padisë, paditësi ka theksuar se i njëjti është i regjistruar si biznes në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar pranë ARBK-së dhe posedon licencën e punës nga organet kompetente. Ka sqaruar se këtu e paditura, i ka bllokuar llogaritë bankare paditëses me arsyetimin se ortakëria e përgjithshme “Ozkor&Batu”, në të cilin ortakëri, aksionari i vetëm i paditësit J.M. ka qenë bashkë ortak me një person tjetër, ka obligime tatimore ndaj ATK-së. Ka shtuar se paditësi nuk e mohon faktin se e paditura ka pasur të drejtë bllokimin e llogarive bankare personale të aksionarit të paditësit J.M. për shkak të obligimeve tatimore të biznesit N.T.P “Ozkor&Batu”, por që e paditura, pa asnjë bazë ligjore, dhe me pretekstin e mbledhjes së detyrueshme të tatimit, ka bllokuar llogaritë bankare të këtu paditësit “Princesha Group” Sh.P.K., dhe subjektit tjetër “Princesha Bani Com” Sh.P.K., përkundër që këto dy subjekte, janë të organizuar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, andaj si të tilla kanë personalitet të ndarë nga aksionari i tyre. Ka sqaruar se me datë 11.04.2014 dhe me datë 30.06.2014, aksionari i paditësit z. J.M., ka bërë kërkesë pranë ATK-së për lirimin e llogarive bankare të subjekteve “Princesha Group” Sh.P.K., dhe subjektit tjetër “Princesha Bani Com” Sh.P.K., ndërsa e paditura, përmes njoftimit nr. 434/14 të datës 07.05.2014 ka njoftuar pronarin e paditësit, se llogaritë bankare të subjektit “Princesha Bani Com” Sh.P.K., deblokohen, kjo meqenëse J.M., në këtë subjekt është aksionar me vetëm 50% të aksioneve ndërsa llogaritë bankare të këtu paditëses “Princesha Group” Sh.P.K., mbesin të bllokuara, kjo për faktin se z. J.M. në këtë biznes paraqitet aksionar me 100% të aksioneve. Ka deklaruar se ky njoftim është në kundërshtim me nenin 78 par.1 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare pasi që paditësi, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, është juridikisht e ndarë nga aksionari i saj, andaj fakti se aksionari i paditësit z. J.M. ka qenë ortak me një ortakëri të përgjithshme e cila ka pasur obligime tatimore tek e paditura, nuk i jep asnjë të drejtë të paditurës që t’i bllokoj llogaritë bankare të një subjekti juridik krejt tjetër.

Përgjatë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën përfundimtare ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke njoftuar gjykatën se paditësi, nuk ka zhvilluar ndonjë procedurë administrative të brendshme pranë ATK-së lidhur me bllokimin e llogarive bankare dhe se nuk

ka zhvilluar as konflikt administrativ pranë Dish –Divizionit Fiskal të Gjykatës Themelore në Prishtinë, por që paditësi ka theksuar se baza juridike e paditësit ka qenë e vërtetuar në tërësi, andaj ka konsideruar se caktimi i ekspertizës financiare ka qenë i nevojshëm për përcaktimin e demit material dhe fitimin e humbur ndaj paditësit kjo pasi që sipas paditësit, për vërtetimin e dëmit nga e paditura, nuk ka qenë e nevojshme të nxirret një vendim administrativ apo të shteren mjetet e brendshme juridike.

I padituri me përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se Administrata Tatimore e Kosoovës, përkatësisht Departamenti i Ankesave, duke vepruar sipas rekomandimeve të Bordit të Pavarur për Rishqyrtime të dhëna në aktvendimin A.nr. 124/2012 të datës 07.11.2014, ka marrë vendimin nr. 469/2014 të datës 09.01.2015 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht ankesën e subjektit N.T.P “Ozkur Baku” lidhur me rivlerësimin e obligimit tatimor. Ka sqaruar se në procedurën e shqyrtimit të obligimeve tatimore të subjektit të lartcekur, paditësi “Princesha Com” Sh.P.K., dhe pronari i saj z. J.M. nuk e kanë ngritur asnjëherë çështjen e bllokimit të llogarive bankare të paditësit, andaj vendimi i Departamentit të Ankesave konsiderohet vendimi i fundit lidhur me pretendimet dhe obligimet tatimore të tatimpaguesve. Tutje ka sqaruar se e paditura, ka pranuar kërkesën e paditësit për zhbllokimin e llogarive bankare dhe ka gjetur se pronari i paditësit z. J.M., është pronar i subjektit tatimor “Cafe Vip” i cili subjekt, nga rezultatet e kontrollit ka rezultuar se ka obligime tatimore në shumë prej 190.874.01 EUR. Mbi këtë bazë, ka sqaruar se Zyra Regjionale Prishtinë e të paditurës, në përpjekje për të inkasuar këtë borxh, ka vendosur barrën tatimore në pasurinë individuale të J.M., e në kuadër të vendosjes së kësaj barre tatimore, janë bllokuar edhe llogaritë bankare të paditëses “Princesha Com” Sh.P.K, në të cilin z. J.M. është aksionar me 100% të aksioneve dhe subjektin “Princesha Bani” Sh.P.K. ku z. J.M. është aksionar me 50% të aksioneve. Ka sqaruar se në përputhje me nenin 33 të Ligjit për Procedurën Tatimore dhe Procedurat, të paditurës, i ipet e drejta që të vendos barrën tatimore në secilën pasuri të subjektit i cili ka obligime tatimore, përfshirë ktu edhe barrën tatimore në entitetet e ndërlidhura me subjektin që ka obligime tatimore.

2. Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor të datës 15.04.2024 ka bërë administrimin e provave si në vijim: vendimi nr.212 i datës 25.10.2012 i lëshuar nga Departamenti i Ankesave i ATK-së; ankesë e paditësit ndaj raportit të rikontrollit date 26.02.2012; aktvendimi A.nr.124/12 date 07.10.2014 nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime

i ATK-së; vendimi nr.469/2014 i datës 09.10.2015; kërkesa për zhblllokim të llogarive bankare date 28.04.2014; kërkesa për zhblllokim të llogarive e datës 11.04.2014; informimi nga ATK i datës 06.05.2014; kërkesë e paditësit drejtuar ATK-së me date 30.06.2014; përgjigje e ATK-së e datës 02.07.2014.

Gjykata pasi ka bërë vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, dhe mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditësit është në tërësi e pa bazuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për arsyet si në vijim:

Nga vendimi nr. 212 i datës 25.10.2012 gjykata konstatoi faktin se Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankeses, ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e subjektit subjektit N.T.P “Ozkur &Baku” me nr. të biznesit 70344856 ashtu që ka ndryshuar pjesërisht vlerësimet për Tatimin për të Ardhurat Personale për periudhën 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, njoftim vlerësimet për TVSH për periudhën 03/2010; 05/2010; 10/2010, 11/2010; 12/2010; 05/2011 dhe 12;2011.

Nga Aktvendimi A.nr.124/12 date 07.10.2014 gjykata konstatoi se Bordi i Pavarur për Rishqyrtime pranë ATK-së, ka aprovuar ankesën e subjektit në procedurë NTP “OZKOR&BATU” me nr. të biznesit 70344856 ashtu që ka anuluar vendimin vendimi nr. 212 i datës 25.10.2012 të Departamentit të Ankesave pranë ATK-së, dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosi.

Nga vendimi nr.469/2014 i datës 09.10.2015 gjykata konstatoi faktin se Administrata Tatimore e Kosovës – Departamenti i Ankesës, në rivendosi përsëri ka aprovuar pjesërisht ankesën e subjektit subjektit N.T.P “Ozkur &Baku” me nr. të biznesit 70344856 ashtu që ka ndryshuar vlerësimet për Tatimin për të Ardhurat Personale për periudhën 2007, 2008, 2009, 2010 dhe 2011.

Nga kërkesa për zhblllokim të llogarive e datës 11.04.2014 gjykata gjeti se paditësi, i është drejtuar zyrtareve udhëheqës tek e paditura, duke i njoftuar se të njëjtit, kanë bërë bllokimin e llogarive bankare të këtu paditësit “Princesha Group” Sh.P.K. dhe subjektit “Princesha Bani Com” në emër të grumbullimit të tatimit të detyrueshëm të biznesit N.T.P “Ozkur&Baku”, përkundër që këto dy entitete janë juridikisht të ndara dhe nuk kanë të bëjnë asgjë me subjektin që i detyrohet të paditurës. Andaj kanë kërkuar nga e paditura që të zhblllokohen llogaritë bankare të bizneseve të lartcekura.

Nga Kërkesa për zhbllokim të llogarive bankare date 28.04.2014, gjykata gjeti se z. J.M., aksionar i vetëm dhe drejtor menaxhues i paditësit “Princesha Group” Sh.P.K., ka njoftuar të paditurën se paditësit, ende nuk i është zhbllokuar llogaria bankare duke deklaruar se pas takimit me zyrtarët e Regjionit Prishtina 3, të njëjtit kanë informuar se lidhur me paditësin nuk ka udhësesë për zhbllokim.

Nga informimi nga ATK i datës 06.05.2014 gjykata konstatoi se e paditura ATK, duke iu përgjigjur kërkesës së paditësit të datës 11.04.2014 dhe datës 28.04.2014 për zhbllokimin e llogarive bankare e ka njoftuar këtë të fundit se kërkesa për zhbllokimin e llogarive bankare është pjesërisht e bazuar, ashtu që ka njoftuar se llogaritë bankare të subjektit “Princesha Bani Com” zhbllokohen, kjo sepse z. J.M., në këtë subjekt është aksionar me vetëm 50% të aksioneve, ndërsa llogaritë bankare të këtu paditëses mbesin të bllokuara konform nenit 33 par.1 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, meqenëse në këtë subjekt, z. J.M. është pronar i 100% të aksioneve.

Nga kërkesa e paditësit drejtuar ATK-së me date 30.06.2014 gjykata konstatoi se paditësi, përsëri i është drejtuar të paditurës për tu informuar lidhur me arsyet e mos zhbllokimit të llogarive bankare të tij, duke kërkuar arsyetim me shkrim lidhur me këtë kërkesë.

Nga përgjigje e ATK-së e datës 02.07.2014 gjykata konstatoi se e paditura, përsëri e ka njoftuar këtu paditësin se duke u bazuar në opinionin e zyrës ligjore të të paditurës, është sugjeruar që llogaritë bankare të subjektit “Princesha Bani Com” të zhbllokohen, kjo sepse z. J.M., në këtë subjekt është aksionar me vetëm 50% të aksioneve, ndërsa llogaritë bankare të këtu paditëses mbesin të bllokuara konform nenit 33 par.1 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, meqenëse në këtë subjekt, z. J.M. është pronar i 100% të aksioneve.

3. Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Meqenëse raporti juridik mes palëve ndërgjyqëse është krijuar në vitin 2014, për vendosje në këtë çështje juridike kontestimore gjykata iu referua Ligjit nr. 04/L-77 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje si LMD).

Sipas Nenit 136.1 të LMD-së përcaktohet që “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”. Referuar dispozitës së lartcekur, për të ekzistuar përgjegjësia për shpërblimin e dëmit duhet të përmbushen kushtet e përgjegjësisë dhe atë: të ekzistojë shkaktuesi i dëmit, të ekzistojë fakti dëmtues, lidhja shkakore

ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar dhe kundërligjshmëria e veprimit nga i cili është shkaktuar dëmi. Ndërsa duke qenë se në rastin konkret, fakti dëmtues pretendohet të jetë shkaktuar në kuadër të veprimeve të të paditurës si organ shtetëror, për vërtetimin e bazës juridike të kërkesës për shpërblimin e dëmit, duhet që me prova konkrete të dëshmohet se veprimet e kësaj të fundit përgjatë procedurës administrative kanë qenë të kundërligjshme.

Në rastin konkret, nga vlerësimi i gjithmbarshëm i provave të administruara, gjykata erdhi në përfundim se paditësi nuk ka arritur të vërtetoj kundërligjshmërinë e veprimeve nga ana e të paditurës si kusht imperativ për mbështetje të kërkesëpadisë për kompensimin e dëmit. Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi pasi që e paditura, vendimin për bllokimin e llogarive bankare të paditësit e ka mbështetur në autorizimet ligjore të cilat i dalin nga neni 33 par.7 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i cili përcakton se *“Barra e përshkruar në paragrafin 1. të këtij neni gjithashtu përvetëson çdo pronë të tatimpaguesit që mbahet nga personi i tretë i cili është konstatuar se mban pronën si i emëruar i tatimpaguesit...”*. Pra e paditura, përveç që ka vendosur barrën tatimore tek subjekti i cili ka pasur obligime tatimore, ka zgjeruar barrën tatimore edhe ndaj këtu paditëses “Princesha Group” Sh.P.K., me arsyetimin se ka ekzistuar lidhshmëria mes subjektit që ngarkohet me tatim dhe subjektit të cilit i vihet barra tatimore.

Në këtë drejtim, përkundër që e paditura përmes njoftimit me nr. reference 06/05/2014 PR 3 e ka njoftuar paditësin se llogaritë bankare i mbesin të bllokuara, këtu paditësi, nuk ka ushtruar asnjë mjet juridik të brendshëm për të kontestuar veprimin e të paditurës në kuadër të procedurës administrative me të cilin janë prekur interesat e tij.

Detyrimi i këtu palës paditëse që t’i shteroj mjetet e brendshme juridike për të kontestuar veprimin e të paditurës përcaktohet qartazi me nenin 77 par.1 të ligjit të lartcitur i cili parasheh se *“Një person i cili kundërshton vlerësimin e tatimeve ose përcaktim zyrtar të ATK mund të paraqesë ankesë në Departamentin e Ankesave për të ri-shqyrtuar përcaktimin zyrtar. Ankesa duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur tatimpaguesi ka pranuar njoftimin e vlerësimit ose përcaktim tjetër zyrtar”*. Ndërsa, në rast se paditësi do ishte i pakënaqur me një vendim eventual të Departamentit të Ankesave të të paditurës, të njëjtit do t’i linde e drejta për të atakuar vendimin e lartcekur në instancën e shkallës së dytë brenda të paditurës, kjo në përputhje me paragrafin 6 të nenit 77 të këtij ligji i cili përcakton se *“Personi i cili nuk pajtohet me një vendim të Departamentit të Ankesave mundet të paraqesë ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtim brenda tridhjetë (30) ditëve pasi është marrë njoftimi i vendimit të Departamentit*

të Ankesave”. Ndërsa, në kuptim të neni 81 të Ligjit, vendimi përfundimtar i këtu të paditurës, sipas padisë së paditësit do mund të rishqyrtohej në konflikt administrativ – divizioni fiskal brenda gjykatës kompetente.

Rrjedhimisht, në mungesë të juridiksionit të gjykatës në procedurë kontestimore për të bërë kontrollin e ligjshmërisë së veprimeve të të paditurës si organ administrativ, e në anën tjetër në mungesë të provave relevante nga të cilat konstatohet kundërligjshmëria e veprimeve të të paditurës, paditësi nuk ka arritur që të dëshmoj bazën juridike mbi të cilën e mbështet kërkesën e tij për kompensimin e dëmit për shkak të bllokimit të llogarive bankare nga këtu e paditura.

Për këto arsye, gjykata, me aktvendimin procedural të marrë përgjatë seancës së datës 06.06.2024, ka refuzuar marrjen e provës me ekspertizë financiare për të përcaktuar lartësinë e dëmit eventual që paditësi ka pretenduar se i është shkaktuar nga veprimet e të paditurës, kjo meqenëse marrja e kësaj prove, nuk do kishte asnjë ndikim në vërtetimin e fakteve sa i përket bazës së kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata vlerësoi edhe vendimet e të paditurës të lëshuara në procedurë administrative dhe atë vendimi nr.212 i datës 25.10.2012 i lëshuar nga Departamenti i Ankesave i ATK-së, aktvendimi A.nr.124/12 date 07.10.2014 i lëshuar nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime i ATK-së, si dhe vendimin nr.469/2014 i datës 09.10.2015 i lëshuar në rivendosje përsëri nga Departamenti i Ankesave i ATK-së, por që vendimet e lartcekura, kanë për objekt shqyrtimi vetëm pretendimet e subjektit juridik N.T.P. “Ozkur Baku” në ndërlidhje me obligimet e saj tatimore, andaj përderisa në këto vendime nuk është paraqitur palë paditësi, dhe nuk janë trajtuar pretendimet për bllokimin e llogarive bankare të saj, vendimet e lartcituara, nuk kanë ndikim në vërtetimin e bazës juridike të kërkesëpadisë së paditësit.

Gjykata pati parasysh edhe provat tjera të administruara në këtë shqyrtim gjyqësor, por gjeti se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen ndryshe si nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi në mbështetje të nenit 450 të LPK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 60/22, datë 25.06.2024

Gjyqtari

Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.